



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-43

PËR AKREDITIMIN

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Rregullores 2001/9 të datës 15 maj 2001 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, Kreu 5.1. (ç), 9.1.1 dhe 9.1.26 (a), si dhe

me qëllim të rregullimit, themelimit dhe funksionimit të organit i cili kryen punët e shërbimit të Akreditimit në Kosovë, përcaktohet fusha ku kryhet akreditimi dhe roli i akreditimit në procedurat e vlerësimit të konformitetit me standardet dhe rregullat teknike dhe në harmoni me standardet e Bashkimit Evropian,

Miraton:

LIGJIN PËR AKREDITIMIN

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet fushëveprimi i Njësisë së Akreditimit e cila funksion në kuadër të Agjencionit për Standardizim të Kosovës, përcaktohet fusha në të cilën kryhet akreditimi si dhe roli i akreditimit në procedurat e vlerësimit të konformitetit me standardet dhe rregullat teknike.

Neni 2

Definicionet të cilat përdoren në kuptim të dispozitave të këtij ligji kanë këto domethënie:

“**Akreditim**” kuptohet procedura e njohjes zyrtare, nga një organizëm i autorizuar, të kompetencës së një organi për vlerësimin e konformitetit me standardet dhe rregullat teknike për të kryer detyra të tilla, si testim, kalibrim, certifikim, inspektim,

“**Autorizim**” kuptohet dhënia, nga ministritë dhe institucionet tjera qendrore përkatëse të drejtës për të kryer vlerësimin e konformitetit me standardet dhe rregullat teknike të produkteve, proceseve, shërbimeve në sferën e detyrueshme, organeve publike ose privatë, vendas ose të huaj që kryejnë veprimtari në territorin e Kosovës,

“**Vlerësimi i konformitetit**” është çdo veprimtari me të cilën në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë vlerësohet nëse janë plotësuar kërkesat e caktuara,

“**Certifikim**” kuptohet veprimtaria e një pale të tretë e të pavarur e cila vërteton nëse procesi, shërbimi ose produkti në fjalë plotëson kërkesat e veçanta të standardeve përkatëse, rregullat teknike ose akteve normative në fuqi,

“**Certifikata e akreditimit**” është dokument në bazë të së cilës vërtetohet kompetenca për kryerjen e detyrave të veçanta në fushën e vlerësimit të konformitetit me standardet dhe rregullat teknike,

“**Inspektim**” kuptohet veprimtaria që kryhet për të vlerësuar fazat e projektimit të produktit, procesit dhe shërbimit në përputhje me kërkesat konkrete, në bazë të vlerësimit profesional ose të kritereve kryesore,

“**Kalibrim**” kuptohet tërësia e veprimeve që përcakton, në kushte të veçanta, marrëdhënien ndërmjet vlerave të treguara nga një mjet matës ose sistem matës, ose të vlerave të dhëna nga një matje materiale si dhe vlerave të njohura, korresponduese të mjetit të matur,

“**Organizëm i vlerësimit të konformitetit**” kuptohet organizmi aktivitetet e të cilit përfshinë testimin, kalibrimin ose certifikimin e produkteve personelit dhe sistemeve përfshirë sistemet e menaxhimit të mjedisit,

“**Sferë e detyruar**” kuptohet sfera, si siguria e jetës, mbrojtja e shëndetit dhe mbrojtja e mjedisit që janë objekt i vlerësimit të konformitetit me standardet dhe rregullat teknike, të detyrueshme të produkteve, proceseve dhe shërbimeve,

“**Testim**” kuptohet veprimtaria teknike, që ka të bëjë me përcaktimin e një ose më shumë karakteristikave të një produkti, materiali, pajisjeje, organizmi, fenomeni fizik, procesi ose shërbimi të dhënë sipas një procedure të veçantë.

II. NJËSIA AKREDITUESE

Neni 3

3.1. Për kryerjen e punëve të akreditimit, kompetente është Njësia e Akreditimit në kuadër të Agjencionit për Standardizim të Kosovës.

3.2. Organizimi dhe funksionimi i Njesisë së Akreditimit rregullohet me Rregulloren e punës së Agjencionit për Standardizim të Kosovës.

NJËSIA E AKREDITIMIT ËSHTË INSTITUCION BUXHETOR, NË KUADËR TË MTI-SË.

Neni 4

Njësia e Akreditimit ka këto detyra:

- i. akreditimin e laboratorëve të testimit/provave;
- ii. akreditimin e laboratorëve kalibrues;
- iii. akreditimin e organeve certifikues;
- iv. akreditimin e organeve inspektues;
- v. mbikëqyrjen e organeve të akredituar;

- vi. ndërprerjen dhe tërheqjen e akreditimit;
- vii. përfaqësimin e Kosovës ne organizatat ndërkombëtare për akreditimin;
- viii. bashkëpunimin me organet kombëtare të akreditimit në vendet e tjera për arritjen e marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellët, rajonale ose ndërkombëtare, ose për të arritur marrëveshje dypalëshe;
- ix. dhënien e këshillave për administratën publike për çështje që lidhen me akreditimin dhe vlerësime të tjera të kompetencës teknike për kryerjen e procedurave të vlerësimit të konformitetit me standardet dhe rregullat teknike;
- x. mbajtjen, azhurnimin dhe dhënien e informacionit për statusin e akreditimit të organizmave të akredituar;
- xi. bashkëpunimin me institucionet tjera të infrastrukturës së cilësisë, ministritë përkatëse dhe shoqatat e interesuara për çështjet e akreditimit.

III. FUSHA E AKREDITIMIT

Neni 5

Me procedurën e akreditimit vërtetohet aftësia e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e punëve për të cilët jepet akreditimi duke u bazuar në kërkesat nga rregullat teknike, standardet përkatëse Evropiane dhe ndërkombëtare, përkatësisht standardet ekuivalente nacionale, si dhe dokumentet e organeve Evropiane dhe ndërkombëtare për akreditim.

Neni 6

6.1. Procedurat e akreditimit të cilat i kryen Njësia e akreditimit përcaktohen me aktin e themelimit dhe akte tjera nënligjore të cilat i nxjerr Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Procedurat e akreditimit bazohen në standardet dhe dokumentet e organizatave evropiane dhe organizatave tjera ndërkombëtare për akreditim.

6.2. Akreditimi bëhet në bazë të kërkesës së personit juridikë apo fizikë.

6.3. Njësia akredituese dhe personi juridik apo fizik i rregullojnë të drejtat dhe obligimet reciproke lidhur me dhënien e vërtetimit për akreditim dhe mirëmbajtjen e akreditimit në bazë të kontratës.

6.4. Njësia akredituese është e obliguar të lidhë kontratë me çdo person juridik dhe fizik që dëshiron të akreditohet. Tek lidhja e kontratës Njësia akredituese domosdo duhet që në mënyrë të qartë të njoftoj personin fizik apo juridik me kërkesat e procedurës së akreditimit. Me kontratë përcaktohen të drejtat dhe obligimet e nënshkruësve të kontratës si dhe zbatimi i procedurës së akreditimit në përputhje me standardet dhe dokumentet sipas nenit 5 të këtij ligji.

6.5. Njësia akredituese vlerëson se personi juridik apo fizik i plotëson kërkesat sipas standardeve, gjegjësisht dokumenteve nga neni 5 të këtij ligji, lëshon Certifikatë për akreditimin e cila nënshkruhet nga shefi i Njesisë së Akreditimit.

6.6. Akreditimi i dhënë është i kufizuar në afat prej pesë viteve. Njësia e akredituar duhet të përmbushë kërkesat për akreditimin të dhënë në afatin e vlefshmërisë së akreditimit.

6.7. Njësia akredituese nxjerr vendim për ndërprerjen e akreditimit kur vërteton se subjekti i akredituar ka pushuar së plotësuari ndonjëherë prej kërkesave të nevojshme për akreditim.

6.8. Kundër vendimit nga paragrafi 7. i këtij neni Njësia për akreditim i paraqitet ankesë sipas vendimit të themelimit dhe procedurave të akreditimit.

Neni 7

Akreditimi bazohet në parimet e paanshmërisë, transparencën dhe përgjegjësisë profesionale. Njësia e Akreditimit është e pavarur nga çdo organizëm i vlerësimit të konformitetit me standardet dhe rregullat teknike dhe ajo nuk përfshihet në këto veprimtari.

Neni 8

Akreditimi për organizmat e vlerësimit të konformitetit me standardet dhe rregullat teknike mund të kryhet nga organizma të huaj akreditimi, të cilët janë anëtare të marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellët, rajonale ose ndërkombëtare ku edhe Njësia e Akreditimit është anëtare ose me të cilat ajo ka marrëveshje dypalëshe

IV. AKREDITIMI LIDHUR ME DISPOZITAT PËR VLERËSIMIN E KONFORMITETIT

Neni 9

9.1. Në dispozitat që rregullojnë vlerësimin e konformitetit mund të përcaktohet mënyra e pjesëmarrjes së Njësia akredituese në procedurën e emërimit të trupit për vlerësimin e konformitetit me kërkesat nga dispozitat.

9.2. Në dispozitat që rregullojnë vlerësimin e konformitetit mund të përcaktohet se në bazë të Certifikimit të akreditimit të presupozohet aftësia e organit për vlerësimin e konformitetit me kërkesat nga dispozitat.

9.3. Aftësia e organit nga paragrafi 2 i këtij neni mund të dëshmohet edhe në mënyrë tjetër.

Neni 10

10.1. Tarifat për kryerjen e të gjitha shërbimeve propozohen nga Njësia e Akreditimit dhe miratohen nga Ministria e Financave. Këto tarifa janë të njëjta si për subjektet vendase, ashtu dhe për ato të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtari në Kosovë.

10.2. Të ardhurat e siguruara nga këto shërbime derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 11

Përdorimi i stemës së akreditimit nga subjekte të pa akredituara apo që u ka mbaruar afati i akreditimit përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë prej 1.000 Euro. deri në 3.000 Euro. Dënimin e shqipton personi i autorizuar nga Njësia e akreditimit.

Neni 12

12.1. Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankesë Njesisë së akreditimit brenda afatit prej 15 ditëve. Ai duhet të përgjigjet brenda 30 ditëve nga data e ankesës.

12.2. Kundër vendimit të Njesisë së akreditimit sipas ankesës, vendos organi kompetent, në kuadër të Agjencionit për Standardizim.

12.3. Kundër vendimit të Agjencionit për Standardizim ose kur nuk përgjigjet në afatin prej 60 ditëve, pala mund të ngritë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit apo skadimit të afatit.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 13

Me datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji ndërpritet vlefshmëria e dispozitave të mëparshme mbi akreditimin.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-43
21 Nëntor 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci